

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT TIRANE  
Nr. 8328 Vendimit

8328

V E N D I M

PER RREGJISTRIM TE PERSONIT JURIDIK PRIVAT

Ne Tirane, sot me date 01.1995, une gjyqtaria e Gjykates se Rrethit Tirane mbasi u njoha me materialet dhe kerkesen e paraqitur nga Kujtim Hyka dhe Xhafer Jaho per rregjistrimin e Shogerise me pergjegjesi te Kufizuar "BESLIDHJA" si person juridik privat,

K O N S T A T O V A

Se dokumentacioni i paraqitur nga kerkuesit :

1. Kujtim Hyka, lindur ne Kruje, me 1.5.1961, banues ne lagjen Nr.1 ne Kruje.
2. Xhafer Jaho, lindur ne Kruje me 3.4.1960, banues ne lagjen Nr.1 ne Kruje.

per rregjistrimin e shogerise "BESLIDHJA" SHPK me objekt:

- Veprintari ne fushen e ndertimit, prodhim parafabrikatesh, prodhim lendesh ndertimi;
- Import - eksport me shumice e pakice te produkteve industriale, ushqimore, etj.

Adresa e shogerise : Lagja Nr.1 Kruje.

Administratore te shogerise do te jene Kujtim Hyka dhe Xhafer Jaho.

Kapitali Themelor eshte 100.000 leke

Afati i Shogerise eshte mbi 10 vjet

eshte i plote dhe i bazuar dhe si i tille ne baze te ligjit duhet pranuar

PER KETO ARESYE

Ne baze te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 dhe te ligjit Nr.7667 date 28.01.1993

V E N D O S A

Rregjistrimin e personit juridik privat te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "BESLIDHJA" SHPK me ortakë:

1. Kujtim Hyka, lindur ne Kruje, me 1.5.1961, banues ne lagjen Nr.1 ne Kruje.

2. Xhafer Jaho, lindur ne Kruje me 3.4.1960, banues ne lagjen Nr.1 ne Kruje.

me objekt:

- Veprimtari ne fushen e ndertimit, prodhim parafabrikatesh, prodhim lendesh ndertimi;

- Import - eksport me shumice e pakice te produkteve industriale, ushqimore, etj.

Adresa e shoqerise : Lagja Nr.1 Kruje.

Administratore te shoqerise do te jene Kujtim Hyka dhe Xhafer Jaho.

Kapitali Themelor eshte 100.000 leke

Afati i Shoqerise eshte mbi 10 vjet

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne shkalle te dyte.

Tirane, me \_\_\_\_\_

GJYQTAR

*M. Dolea*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT TIRANE  
Nr. 8328/1 Vendimit

V E N D I M  
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 4.07.2001 une gjyqtare e gjykates se rrethit Tirane Majlinda Dogga mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Kujtim Hyka per depozitimin prane rregjistrarit tregetar te Gjykatës se rrethit Tirane te vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise tregetare " BESLIDHJA " shpk dhe

K O N S T A T O V A

Se me vendimin nr. 8328 date 24.01.1995 eshte rregjistruar si person juridik shoqeria tregetare " BESELIDHJA " shpk, me dy ortakë Kujtim Hyka dhe Xhafer Jaho.

Me vendimin e asamblese se ortakeve te kesaj shoqerie eshte vendosur te largohet nga kjo shoqeri ortaku Xhafer Jaho dhe ti shitet kuota e kapitalit fillestar ne masen 50 % ortakut te ri qe futet ne kete shoqeri z. Azgan Goca , si dhe shkarkimi si administrator i shoqerise i z. Xhafer Jaho.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr. 7667 date 28.1.1993 dhe te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.


Depozitimin prane rregjistrarit tregetar te Gjykatës se rrethit Tirane te vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise tregetare " BESELIDHJA " shpk nr. 1 date 2.7.2001, si dhe depozitimin e kontrates se shitjes se kuotave me nr. 2018 rep date 2.7.2001, per largimin si ortak nga shoqeria te z. Xhafer Jaho dhe shitjen e kuotes se kapitalit fillestar ne masen 50 % ortakut qe futet i ri ne kete shoqeri z. Azgan GOCA.

si dhe shkarkimin si administrator te shoqerise  
te z. Xhafer Jaho, duke ngelur administrator z.  
Kujtim Hyka.

Urdherohet zyra e rregjistrimit tegetar  
te Gjykates se rrethit Tirane te beje ndryshimet  
perkatese ne kollonen \_\_\_\_\_ germa \_\_\_\_\_ si dhe te behet  
ndarja me vize te kuqe nga njeri rregjistrim tek  
tjetri.

GJYQTARE

MAJLINDA DOGGA





## AKTI THEMELUES

### I SHOQERISE "BESELIDHJA SHPK" (Kontrate)

Ky akt themelimi u perpilua ndermjet zoterinjve :

1. Kujtim Hyka, lindur ne Kruje, me 1.5.1961, bannes ne lagjen Nr.1 ne Kruje.
2. Xhafer Jaho, lindur ne Kruje me 3.4.1960, bannes ne lagjen Nr.1 ne Kruje.

te quajtur me poshte ortakë;  
te cilet ne perputhje me ligjin Nr 7632, date 4.11.1992 "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregetar", me ligjin Nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" si dhe me aktet e tjera te legjislacionit shqiptar qe trajtojne keto ceshtje, rane dakort si me poshte:

#### I. F O R M I M I

##### 1.1 Formimi i Shoqerise

Ortakët Kujtim Hyka dhe Xhafer Jaho formojne nje shoqeri private me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me kraun e katert te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare"

##### 1.2. Emri

Emri i Shoqerise do te jete "BESELIDHJA" SHPK.

##### 1.3. Objekti i Shoqerise

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise "BESELIDHJA" shpk eshte si vijon:

- Veprimtari ne fushen e ndertimit, prodhim parafabrikatesh, prodhim lendesh ndertimi;
- Import - eksport me shumice e pakice te produkteve industriale, ushqimore, etj.



#### 1.4. Adresa e Shoqerise

Selia qendrore e perkoheshme e shoqerise do te jete ne qytetin e Krujes, lagja Nr.1. Sipas vendimeve te miratuara ne perputhje me statutin e shoqerise, ajo mund te hape dege, zyra, filiale, apo perfaqesi ne qytete te tjera ne Shqiperi ose jashte saj.

#### 1.5 Afati i Shoqerise

Afati i veprimtarise se Shoqerise percaktohet mbi 10 vjet. Si dite fillestare do te merret data e rregjistrimit te saj ne Gjykatën e Tiranës. Ortaket kane te drejte te zgjasin kete afat.

#### 1.6. Kapitali

Kapitali themelor eshte ne vleften 100.000 leke (njegjind mije) dhe ndahet ne kete menyre:

Kapitali ndahet ne 100 aksione nga 1000 leke secili, teresisht i derdhur dhe i numeruar nga 1 deri ne 100. Pjesmarrja e secilit ortak eshte:

- Kujtim Hyka 50 aksione
- Xhafer Jaho 50 aksione

Kapitali themelor do te jete kontribut ne para dhe eshte i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

#### 1.7. Fitimi

Fitimi realizuar nga aktiviteti i Shoqerise do te ndahet midis ortakeve ne perpjestim me pjeset e vena ne kapitalin themelor, pra:

- Ortaku Kujtim Hyka do te marre 50% te fitimit te realizuar
- Ortaku Xhafer Jaho do te marre 50% te fitimit te realizuar.

#### 1.8. Ruajtja e sekretit

Secili nga Ortaket angazhohet per veten dhe bashkepunetoret e vet qe te mos i tregojne ndonje personi jashte shoqerise informacionet qe do te disponoje shoqeria, kontratat qe ajo do te lidhe si dhe planet ose qellimet qe ajo ka per te ardhmen.



## II. K A P I T A L I

### 2.1. Kontributet e kapitalit

Sasia e kapitalit social te derdhur sipas pikes 1.6 te ketij akti themeltar do te quhet "KONTRIBUT KAPITALI", kontribut ky ne te cilet palet kane kuotat e percaktuara sipas dispozites.

KONTRIBUTI I KAPITALIT fillimisht do te perdoret per shpenzimet fillesstare te Shoqerise.

Secili ortak ka te drejte ti beje shtese kuotes se vet si kontribut kapitali.

### 2.2. Financimi

Per qaq sa do te jete e mundur shoqeria ka te drejte te siguroje financim tregetar ose investues nga cdo banke e institucion financiar, te huaja ose shqiptare, financim qe do te rregullohet me ane te kontratave ose marreveshjeve te posacme me pelqimin e ortakëve.

### 2.3. Ceshtjet financiare dhe llogarit e Shoqerise

Shoqeria do ti mbaje llogarite duke u mbeshtetur ne lekun shqiptar dhe ne valutat e forta. Per kete arsye ajo ne banken me te cilen do te operoje do te kete dy llogari rrjedhese, njerën me monedhen shqiptare dhe tjetren me valute te forte te huaj ( si dollare, marka, lireta, sterlina etj).

Shoqeria do te kete si vit fiskal vitin kalendarik.

## III STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

### 3.1. Organet e Shoqerise

Organet e Shoqerise jane:

- Asambleja, e cila perbehet prej dy ortakëve themelues.
- Administratoret qe jane te dy ortakët
- Ekspertet kontabel

Numri i votave te cdo ortaku eshte i barabarte me pjeset e kapitalit themelues qe ka ai ne shoqeri.

3.2. Secili ortak deri ne ndertimin e shoqerise dor te perballoje shpenzimet qe i takojne. Shpenzimet e metejshme qe lidhen me aktivitetin e shoqerise do ti ngarkohen shoqerise mbi

bazën e rritereve , kushteve dhe modaliteteve të përcaktuara  
ndërmjet ortakeve me marrëveshje të vecante.

3.3. Të gjitha komunikimet ndërmjet ortakeve, si dhe  
ndërmjet përfagesuesve të ortakeve të shqëritur do të kenë vlerë  
në rast se do të komunikohen me letra rekomandë, telegrame,  
telekse, telefakse ose dorazi. Vendimet e marra nga asamblea do  
të kenë vlerë pasi të noterizohen.

#### IV. DISPOZITE E FUNDIT

4.1. Ndryshimet në këtë Akt mund të bëhen vetëm me  
shtesë me shkrim pas miratimit paraprak nga themeluesit.

Pjesë e pandarë e këtij Akti është statuti i  
Shqëritur i cili do të nënshkruhet njëkohësisht nga themeluesit e  
shqëritur.

4.2. Ky Akt Themelimi u hartua në Tiranë sot me datë  
23.01.1995, në 5 ekzemplare në gjuhën shqipe duke patur secili  
prej tyre të njëjten vlerë.

#### ORTAKET

KUJTIM HYKA

XHAFER JAHO

REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E DREJTËSISE  
NOTERIA

Nr. 111 Kol.  
Nr. 189 Rep.

#### VERTETIM

Sot me datë 24 01.1995 (nëntëdhjetë e pesë) u paraqiten  
personalisht përpara meje Kujtim Hyka dhe Xhafer Jaho, të  
panjohur prej meje, për identitetin e të cileve u sigurova nga  
letërnjoftimet personale që ata paraqiten, madhore meqë të  
plotë juridike për të vepruar të cilët me deklaruan se kanë  
hartuar jashtë kësaj zyre këtë Akt Themelimi dhe pasi e firmosën  
në noterië e vertetova sipas llogarit.



NOTERE

*Shënim*  
*[Signature]*



S T A  
I SHOQERISE SHPE



Ky statut perfundohet ndermjet:

1. Kujtim Hyka, lindur ne Kruje, me 1.5.1961, banues ne lagjen Nr.1 ne Kruje.

2. Xhafer Jaho, lindur ne Kruje me 3.4.1960, banues ne lagjen Nr.1 ne Kruje.

te quatit me poshte ortake  
te cilet me vullnetin e tyre u moren vesh te krijojne nje  
Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

K R E U I

FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA

N E N I 1

FORMA

Ortaket e mesiperm kane krijuar nje shoqeri me  
pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi  
ne Shqiperi dhe me dispozitat e ketij Statuti.

N E N I 2

EMERTIMI I SHOQERISE

Emertimi i Shoqerise do te jete "BESLIDHJA" SHPE

N E N I 3

SELIA E SHOQERISE

Selia qendrore e shoqerise do te jete ne Kruje ne  
lagjen Nr.1. Me vendim te Asamblese se Ortakeve, mund te hapen  
dege, zyra, filiale ose perfaqesi te Shoqerise ne qytete te tjera  
te Shqiperise ose jashte saj.

N E N I 4

KOHEZGJATJA

Shoqeria do te kete nje kohezgjatje mbi 10 vjet.  
Si dite fillestare merret data e rregjistrimit te saj ne Gjykatën  
e Tiranës.



## N E N I 5

### OBJEKTI I SHOQERISE

Objekti i veprimtarisë ekonomike të shoqërisë "BESLIDHJA" është si më poshtë:

- Veprimtari në fushën e ndërtimit, prodhim parafabrikatesh, prodhim lëndesh ndërtimi;
- Import - eksport me shumicë e pakicë të produkteve industriale, ushqimore, etj.

## K R E U II

### KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESËT E KAPITALIT THEMELTAR

## N E N I 6

### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është 100.000 leke (njëqindmijë)

Ky kapital do të çelët në një nga bankat që veprojnë në Tiranë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të perfagesohen nga letra me vlerë të trashëgueshme.

## N E N I 7

### KONTRIBUTET

Kapitali ndahet në 100 aksione nga 1000 leke secili, teresisht i derdhur dhe i numeruar nga 1 deri në 100. Pjesëmarrja e secilit ortak është;

- Kujtim Hyka 50 aksione
- Xhafer Jaho 50 aksione

Kapitali themelor do të jetë kontribut në para dhe është i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm. Ortaket kanë të drejtë të zmadhojnë kapitalin e tyre në natyrë dhe në para. Në keto raste behen veprimet përkatëse si për pjesëmarrjen e ortakëve në kapitalin themeltar. Ortaket kanë të drejtë të zvogelojnë kapitalin e tyre. Zvogëlimi bëhet në proporcion të drejtë për çdo ortak në masën e kontributit themeltar.



## N E N I 8

### NDARJA E FITIMIT

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqërisë do të ndahet midis ortakëve në përpjestim me pjesët e vena në kapitalin themelor, pra:

- Ortaku Kujtim Hyka do të marrë 50 % të fitimit të realizuar
- Ortaku Khafer Jaho do të marrë 50 % të fitimit të realizuar

## N E N I 9

### TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR

Kuotat mund të transferohen me anë aktesh mes të gjalleve dhe në trashëgimi. Transferimi i kuotave nuk i nënshtrohet asnjë lloji kufizimi n.q.s. ndodh në rast vdekje.

Sa për transferimin e kuotave me anë aktesh midis të gjalleve, e drejta e preferencës u përket ortakëve në përpjestim me kuotat e zotëruara.

Për këtë arsye ortaku që ka ndermend të transferojë me anë pagese kuotat e veta duhet të kujdeset paraprakisht, të komunikojë ortakut tjetër sasinë e saktë të shumës për të cilën bëhet fjale, kushtet dhe modalitetet e pagimit për të cilat është rënë dakort si dhe gjeneralitetet e personit fizik dhe juridik që mund të marrë këto kuota.

Ortaku që ka ndermend të ushtrojë të drejtën e preferencës duhet ta bëjë këtë të ditur brenda 60 ditësh ndërsa marrja e propozimit për shitje duhet u kujdesur që të fiksojë ditën dhe vendin për nënshkrimin.

Asambleja e ortakëve, pasi ta ketë shqyrtuar dokumentacionin që ka lidhje me ushtrimin e së drejtës së preferencës dhe konformitetin e propozimit për shitje me rezultatet e aktit të transferimit, do të kujdeset të regjistrojë në librin e ortakëve transferimin e kuotave.

## K R E U III

### MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQËRISE

## N E N I 10

### ORTAKET DHE ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Asambleja e ortakëve organizon, drejton dhe kontrollon gjithë aktivitetin e shoqërisë.

Ortakët përballojnë humbjet e Shoqërisë deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre.

Cdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblese së ortakëve dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesë të kapitalit themeltar që zotëron.



Ne ushtrimin e te drejtes per te marre pjese ne vendimet kolektive cdo ortak ka te drejte te perfagesohet nga nje person tjeter i zgjedhur prej tij me akt noterial.

#### N E N I 11

#### DREJTIMI I SHOQERISE

Organi me i larte drejtues i shoqerise do te jete Asamblea e ortakëve.

Asamblea eshte e zakonshme ose e jashtezakonshme.

Asamblea e zakonshme duhet te mblidhet te pakten 2 here ne vit, por asamblea si e zakonshmeja edhe e jashtezakonshmeja mund te mblidhet per sa here qe organi administrativ e gjen me vend.

#### N E N I 12

#### FORMALITETET E MBLEDHJES

Asamblea mund te mblidhet me leter rekomande derguar anetareve te saj te pakten 15 dite para mbledhjes.

Letra e thirrjes do te permbaje pershkrimin e vendit, te dites e te ores se mbledhjes dhe rendin e dites te ceshtjeve qe do te trajtohen.

#### N E N I 13

#### KOMPETENCAT E ASAMBLESE

Asamblea vendos per keto ceshtje:

- Zgjedh personin apo personat qe do te drejtojne shoqerine (administratoret).
- Emeron ekspertet kontabel
- Miraton bilancin vjetor.
- Shperndan rezerven qe ka ne dispozicion.
- Ben ndryshime ne statut.
- Vendos per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themelor.
- Vendos per shperndarjen e shoqerise.
- Ne rastin e shperndarjes se shoqerise cakton likuidatorin dhe e shkakton ate kur perfundon likuidimi.
- Vendos per cdo problem tjeter qe i vihet ne rend te dites.

#### N E N I 14

#### PROCESVERBALET

Vendimet e Asamblese duhen hedhur ne proces verbal, i cili nenshkruhet nga drejtuesit e saj dhe nga noteri.



## N E N I 15

### VLEFSHMERIA E VENDIMEVE

Asamblea e zakonshme, si ne thirrjen e pare edhe ne te dyten vendos me shumice votash. Thirrja e dyte behet kur ne te paren nuk jane prezent te gjitha ortaket brenda 30 diteve nga thirrja e pare.

## N E N I 16

### MODALITETET E VOTIMIT

Vendimet miratohen sipas menyrave te votimit qe percaktohen rast pas rasti nga mbledhja e ortakeve.

## N E N I 17

### ADMINISTRIMI

Shoqeria do te administrohet nga ortaket Kujtim Hyka dhe Xhafer Jaho.

## N E N I 18

### KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Per realizimin e aktivitetit te shoqerise dhe zbatimin e vendimeve te mbledhjes se asamblese se ortakeve, administratoret kane te drejten e firmes.

Per probleme te vecanta administratoret autorizojne per ti perfagesuar ata dhe nje person te trete.

Administratoret kane keto kompetenca:

- te bejne drejtimin e shoqerise midis mbledhjeve te Asamblese se ortakeve
- te perpilojne kontratat dhe cdo akt tjeter juridik qe ka te beje me veprimtarine e shoqerise;
- te hapin llogari rrjedhese bankare prane bankave shqiptare e jashte shtetit;
- te depozitojne e te terheqin shuma parash;
- te fillojne procedura gjyqesore e te mbrohen ndaj veprimeve gjyqesore dhe administrative;
- te emerojne nepunes te rangjeve te ndryshme per veprime te vecanta teknike ose per nje kategori te caktuar veprimesh;
- te bejne gjithshka tjeter qe konsiderojne te dobishme dhe qe eshte ne perputhje me frymen e ketij Statuti e te Aktit Themelues si dhe me legjislacionin shqiptar ne fuqi, per te arritur qellimin dhe objektin social te shoqerise.



## N E N I 19

### KOMPENSIMI

Organit administrativ i takon shperblimi i shpenzimeve dhe nje kompensim eventual i percaktuar nga asamblea.

## N E N I 20

### ORGANI SINDIKAL

Ky organizem do te organizohet dhe do te funksionojë ne baze te ligjit shqiptar.

## K R E U IV

### LIBRAT E SHOQERISE, BILANCI, FITIMI SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI

## N E N I 21

### LIBRAT SOCIAL

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje, pervec dokumentacionit kontabel qe kerkon legjislacioni ne fuqi edhe keto libra:

1. Libri i ortakeve ne te cilin shenohen emrat e plote te ortakeve dhe kuotat qe secili ka ne kapitalin e themelimit.
2. Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te Asamblese
3. Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te administrator-eve.
4. Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te organit sindikal.

Tre librat e pare mbahen ne kujdesin e administratorëve, kurse i katerti nen kujdesin e organit sindikal

## N E N I 22

### VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, EKSPERTET KONTABEL

Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar mund te filloje pas 1 Janarit 1995 por do te perfundoje me 31 Dhjetor 1995

Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e kryera gjate vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratorët miratohen nga Asamblea e ortakeve.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 3 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar. Shoqeria do te jete e kontrolluar nga nje organ i perbere prej 1 ose 3 eksperte kontabel te emeruar nga mbledhja e asamblese se ortakeve. Ata funksionojne sipas kerkesave te Nenit 69 te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992.



## N E N I 23

### ZGJATJA E AFATIT

Zgjatja e afatit të shoqërisë që është përcaktuar në këtë Statut, mund të vendoset nga Asambleja, me shumicën e ortakeve që zotërojnë mbi 3/4 e pjesëve të kapitalit themelor.

## K R E U V

## N E N I 24

### AKTIVITETI FINANCIAR

Në mbyllje të çdo viti financiar administratorët bëjnë inventarin dhe llogarinë vjetore në përputhje me dispozitat e legjislativës në fuqi për kontabilitetin si dhe hartojnë një raport me shkrim.

Bilancit i bashkëgjatët:

- a) Një situacion mbi garancitë e dhëna nga shoqëria.
- b) Një situacion mbi sigurimet e bërë nga shoqëria.

Raporti i administratorëve përfshin gjendjen gjatë vitit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e mundshme që janë zhvilluar nga data e mbylljes së vitit financiar deri në ditën që është hartuar ky raport.

Dokumentet vihen në dispozicion të ekspertëve kontabel të autorizuar, të paktën një muaj para mbledhjes së asamblesë.

## N E N I 25

Fitimet neto të shoqërisë do të konsiderohen fitimet që realizohen pas zbritjes nga të ardhurat bruto të të gjitha shpenzimeve që kanë lidhje me aktivitetin e shoqërisë, detyrimet fiskale, sigurimet shoqërore, detyrimet, amortizimet etj., në përputhje me legjislativën shqiptare.

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera të vecanta financimi.

Perberja, shuma e përgjithshme, burimet për krijimin e fondit rezervë, përdorimi dhe rregullimi i çdo fondi të vecantë caktohen nga administratorët në përputhje me legjislativën shqiptare.

Në përputhje me nenin 213 të ligjit "Për shoqëritë tregëtare" nga fitimi i rezervuar gjatë vitit financiar lihet menjëherë një shumë me vlerë 1/20 e cila destinohet për formimin e një fondi "rezervë e domosdoshme".



## N E N I 26

### PRISHJA E SHOQERISE

Shoqeria priset me kalimin e afatit te caktuar ne statut. Per arsye qe parashikohen ne ligj shoqeria priset para afatit me vendim te Asamblese. Shoqeria nuk priset kur njeri nga ortakët behet i paafte ose vdes.

## N E N I 27

Shoqeria nuk guhet e prishur kur kapitalet perqendrohen ne doren e nje ortaku te vetem.

## N E N I 28

Rastet e pavlefshmerise se shoqerise ose te nje akti qe ndryshon statutin si dhe bashkimi dhe ndarja e shoqerise behet ne perputhje me dispozitat e ligjit per "Shoqerite Tregetare".

## N E N I 29

Kur shoqeria priset ajo kalon ne likuidimin dhe ne kete rast emertimit te shoqerise i shtohet shenimi "Shoqeri ne likuidim e siper". Shoqeria edhe gjate procesit te likuidimit vazhdon si person juridik privat deri ne perfundimin e procesit te likuidimit.

Prishja e shoqerise eshte me pasoja ndaj te treteve vetem mbas publikimit te prishjes ne regjistrin tregetar.

## N E N I 30

Per te perfunduar procesin e likuidimit, asamblea emerone nje ose disa persona si likuidues te cilet perfaqesojne shoqerine. Likuiduesi perpilon bilancin financiar, likuidon tek te tretet detyrimet e shoqerise, shet aktivin e shoqerise dhe ndan tepricat ne dispozicion.

Likuidues mund te jete njeri nga ortakët.

Ne rast se ortakët nuk kane mundesi te emerojne nje likuidues ai emerohet nga gjykata.

## N E N I 31

Ne periudhen e likuidimit ortakët mund te njehen me te gjithë dokumentet e shoqerise ne te njejtat kushte si edhe me pare.

## N E N I 32

Ne perfundim te mbylljes se likuidimit, ortakët thirren qe te vendosin per bilancin financiar perfundimtar, per aktin e rregullueshmerise, per administrinin nga ana e likuiduesit dhe



per shprehjen e mandatit te likuiduesit si dhe per tu evidentuar  
mbledhjen e likuidimit. Dokumentat e mesiperme miratohen nga  
Asambleja me unanimitet.



#### N E N I 33

Kur shoqeria likuidohet pasurite qe jane vene ne  
dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, u kthehen  
pronareve. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise  
se shoqerise, pasurite dhe fondet fillestare ndahen ndermjet  
ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena, pasi tu jene bere  
pagesat per kreditorët.

#### N E N I 34

#### DISPOZITAT E FUNDIT

Ne rast se ortakët kane mosmarreveshje ne menyren e  
likuidimit te shoqerise, kete e zgjidhin ne rruge gjyqesore,  
sipas dispozitave perkatese te parashikuara ne ligjin per shoqer-  
ite tregetare.

#### N E N I 35

Shoqeria ka te drejte te punesoje punonjes qe i nevoji-  
ten per te ushtruar veprimtarine e saj. Punesimi behet sipas  
kushteve te percaktuara ne legjislacionin e punes se Republikes  
se Shqiperise, si dhe rregullave te vena ne kontraten e vecante  
te punesimit qe lidhet midis punedhenesit e punonjesit.  
Shoqeria u garanton punonjesve kushte pune dhe mjete te  
nevojshme per realizimin e detyres qe kryejne.

#### N E N I 36

Te gjitha problemet qe do te lindin gjate ushtrimit te  
veprimtarise private te kesaj shoqerie do te zgjidhen sipas  
rregullave te percaktuara ne statutin dhe legjislacionin ne fuqi  
ne Republiken e Shqiperise.

Kur mosmarreveshjet nuk zgjidhen me mirekuptim  
kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Tiranes.

#### N E N I 37

Ky statut firmoset nga palet me vullnetin e tyre te  
lire.

ORTAKET

KUJTIM HYKA

XHAFER JAHO



K E R K E S E

PER RREGJISTRIMIN E SHOQERISE TREGETARE  
BESLIDHJA - SHPK

*St. 24-1-95*  
*Delia*

Gjykates se Rrethit Tirane

Mbeshtetur ne ligjin Nr.7667 date 28.1.1993 "Per rregjistrimin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregetare" kemi nderin ti kerkojme kesaj Gjykate rregjistrimin e Shoqerise sone ne rregjistrin tregetar sipas kerkesave te ligjit te siperpermendur.  
Shoqeria do te jete e tipit te "Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar" e themeluar nga ortakët Kujtim Hyka dhe Xhafer Jaho.

Emri i i Shoqerise do te jete "BESLIDHJA" SHPK  
Qendra e shoqerise do te jete ne lagjen Nr.1 Kruje.

Objekti, kapitali baze dhe administrimi i Shoqerise percaktohen ne statutin dhe kontraten qe i jane bashkengjitur kesaj kerkese.

Shoqeria merr persiper te kryeje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me legjioslacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Afati i veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 10 vjet.

Administratore te shoqerise do te jene Kujtim Hyka dhe Xhafer Jaho.

Mbetemi me shprese se kerkesa jone do te merret sa me shpejt ne konsiderate.

Me respekt

KUJTIM HYKA

XHAFER JAHU

Tirane, me                      1995

8328/1

s'ks

3. M. Degg  
03.7.2001  
03 LUG. 2001

M. OI 2001

KERKESE

KERKUESI Kujtim Hyka administrator i shoqerise  
tregetare " BESELIDHJA " shpk banues ne  
Kruje.

OBJEKTI Depozitimin prane rregjistrit tregetar te  
Gjykates se rrethit Tirane te vendimit te  
asamblese se ortakeve te shoqerise tregetare  
" BESLIDHJA " shpk.

Ja shprehur  
Kerkesa

GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

Me vendimin nr.8328 date 24.01.1995 eshte  
rregjistruar si person juridik shoqeria tregetare  
"BESELIDHJA " shpk.

11 Vendi asg wblek  
ortafren  
alt  
2.7.2001

Me vendimin e asamblese se ortakeve te  
kesaj shoqerie es te vendosur largimi nga kjo shoqeri  
e ortakut Xhafer Jaho dhe shitja e kuotes se kapitalit  
fillestar ne masen 50 % ortakut qe futet ne kete  
shoqeri z. Azgan Goca. Shkarkimin si administrator te  
shoqerise te z. Xhafer Jaho.

7. Vendi shite banor  
2.7.2001  
4.7.2001

Kerkojme depozitimine ketij vendimi prane  
rregjistrit tregetar.

KERKUESI

XHAFER JAHOK  
KUJTIM HYKA

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA E TIRANES

Nr. 2016 Rep

Tirane ,me 02.7.2001

VERTETIM

Vertetohet se kerkesa e paraqitur nga kerkuesi  
per depozitimine vendimit te asamblese se ortakeve te  
shoqerise " BESELIDHJA " shpk u nenshkrua ne prezencen time  
nga kerkuesi Kujtim Hyka per indetitetine te cilit  
u sigurova nga dokumenti indetifikues dhe une noter e  
vertetoj sipas ligjit.



Noteri  
Vargjel Jone

V E N D I M

NR! 1 date 2.7.2001

I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE TREGETARE

" BESELIDHJA " shpk

Ne asambleja e ortakeve te shoqerise tregetare " BESELIDHJA " shpk e perbere nga ortaket Xhafer Jaho dhe Kujtim Hyka ne mbledhjen e dates 2.7.2001 unanimitisht dhe pa verejtje kemi vendosur:

Largimin nga kjo shoqeri te z. Xhafer Jaho duke ju sh tur kuota e kapitalit fillestar ne maeen 50 % baraz kjo me 50 .000 leke ortakut te ri qe futet ne kete shoqeri z. Azgan Goci.

Shkarkimin si administrator te shoqerise te z. Xhafer Jaho.

Mbledhja u mbyll me kete rend dite

ORTAKET E SHOQERISE TREGETARE

" BESELIDHJA " SHPK

XHAFER JAHO

KUJTIM HYKA

REPUBLIKA E SHQIPERISE


NOTERIA E TIRANES

Nr. 2018 Rep

Tirane ,me 02.7.2001

VERTETIM

Vertetohet se vendimi i asamblese se ortakeve te shoqerise tregetare " BESELIDHJA " shpk u nenshkrua ne prezencen time nga ortaket Xhafer Jaho dhe Kujtim Hyka per indetitetin e te cileve u sigurova nga dokumenti indetifikues dhe une noter e vertetoj sipas ligjit.



KONTRATE SHITJE KUOTASH

Ne Tirane sot me date 7.2001 para meje noterit u paraqiten personalisht palet per hartimin e kontrates se shitjes se kuotave te kapitalit si me poshte:

SHITESI Xhafer Jaho i biri i Dilaverit i dtl. 1980 lindur e banues ne Kruje lagja nr. 1, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar.

BLERESI Azgan Goci i biri i Imerit dhe i Nafijes i dtl. 1957 lindur e banues ne Kruje lagja nr. 1 madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar indetifikuar me nr. pasaporte Ev 123417.

Shitesi Xhafer Jaho eshte ortak ne shoqerine tregetare " BESELIDHJA " shpk e rregjistruar si person juridik me vendimin nr. 8328 date 24.1.1995 me nje kapital fillestar 50 % baraz kjo me 50.000 leke. Me vendimin e asamblese se ortakeve te kesaj shoqerie eshte vendosur largimi nga kjo shoqeri e ortakut Xhafer Jaho duke ju shitur kuota e kapitalit ortakut te ri qe futet ne kete shoqeri z. Azgan Goca ne masen 50 % baraz kjo me 50.000 leke i cili eshte dakort qe te bleje kete kapital.

Qe nga momenti i berjes se kesaj kontrate shitje kuotash ortaku qe largohet Xhafer Jaho zhvishet nga te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe i perkasin shoqeri qe nga momenti i berjes se kesaj kontrate. Te drejtat dhe detyrimet i kalojne ortakut qe futet ne kete shoqeri z. Azgan Goca

SHITESI  
XHAFER JAHU



BLERESI  
AZGAN GOCI

